

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Së pari, më lejoni të shpreh urimet e mia për të gjithë kolegët e rizgjedhur, aq më tepër për kolegët e rinj. Duke parë prezantimin triumfues të zotit Rama dhe të kabinetit të tij në seancën e sotme, më kaloi në memorie një lexim fragmentar i kësaj vere në lidhje me Bonapartin. Në kulmin e lavdisë së tij i thotë nënës së tij, Letizia Bonaparti: “Nënë, e shikon se sa i madh është bërë biri yt, perandori vetë!”. Korsikania e mençur me këmbë në tokë i thotë: “Po, more bir, por sa do të zgjasë kjo?!”. Ishte ankthi i një nëne për birin e saj në dëlirin e tij. Nëse kjo histori është pak e njohur, është e mirënjohur për të gjithë Vaterloja e Bonapartit dhe për fatin tonë të keq nuk do të jetë vetëm Vaterloja juaj, e cila është e garantuar, por do të jetë me pasoja të rënda për qytetarët, për shoqërinë dhe për vendin. Sot do të dëshiroja me gjithë zemër të uroja zonjat ministre, në qoftë se do të ishin të tilla. A ka ministre në Republikën e Shqipërisë?! Nuk ka. Ka përmbaues të vullneteve dhe të vendimeve të njëshit. Urimi im i përzemërt, zonja të nderuara, është ngrihuni në nivelin e kërkesave të të qenit ministre, sepse një institucion i tillë gjatë 8 vjetëve të fundit, fatkeqësisht, nuk ka ekzistuar. Dëgjova me shumë vëmendje, por për të qenë edhe më i bindur për ato që doja të thosha lexova programin e qeverisë, një pingpong i vazhdueshëm sloganesh, siç thonë andej nga anët e mia: “Rrush i vjetshëm dhe i thartë”, pa një bosht, si një telajo piktori, ku me një spatul ishin hedhur bojëra pa sistem, pa kuptim, me shpresën se mund të dalë një kryevepër abstraksioniste, veçse gjëra të tilla nuk ndodhin në politikë. Cili duhej të ishte boshti, për të cilin duhej folur sot?! Integrimi. Që në vitin 2014 nuk është shënuar asnjë hap përpara në lidhje për integrimin. A ka njeri përgjegjësi?! Po, e paska Bashkimi Europian! Në vend të integritit, na flitet për “Open Balkan” dhe na flitet për “Open Balkan” në emër të lëvizjes së mallrave, të shërbimeve dhe të qytetarëve. Po pse?! Në qoftë se të gjitha këto do të inkuadroheshin brenda nismës së Berlinit, ku do të përfshiheshin 6 vende dhe jo 3, nuk do të ishte më mirë për lëvizjen e qytetarëve, të mallrave dhe të shërbimeve që me kaq forcë dhe patetizëm na u tha sot nga Kryeministri?! Zonja dhe zotërinj, askush nuk mund të jetë kundër hapjeve rajonale në çdo drejtim, në të mirë të shoqërive dhe të rajonit, por a mund të na sqarohet se çfarë vlerë të shtuar ka kjo nismë për procesin e integritit? Ku janë mbivendosjet? Ku janë prurjet e reja? Mos vallë kjo krijon ndërlikime të procesit të integritit, duke ndërvarur fatet e integritit të vendit tonë me fatet e vendeve të tjera, për të cilat natyrisht që urimi ynë nuk mund të jetë i ndryshëm, por të integrohen sa më shpejt në realitetin europian.

Pra, të famshmet “coupling&decoupling” a i studion qeveria jonë për këto nisma që merr dhe a do të na i sjellë t’i diskutojmë në këtë forum dhe në këtë podium, që edhe qytetarët të kuptojnë çfarë po ndodh dhe përse po ndodh?! Zonja dhe zotërinj, për fat të keq, në lidhje të ngushtë me fatet e integritit nuk mund të mos ishin edhe zgjedhjet e fundit parlamentare. Zgjedhjet në vendin tonë, për fat të keq, janë shndërruar si guri i Sizifit që, me gjithë presionin e ndërkombëtarëve, përpjekjet herë të sinqerta dhe herë me prapamendime arrijmë të gjithë së bashku deri në njëfarë momenti, por përsëri shkëmbi i zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike na kthehet dhe na çon sërish në fund. Nuk mund të integrohemi, thotë poeti Kavafis, por jo për rastin e Bashkimit Europian. Po i huazoj vargjet: “Aty ka legjislatorë të zotë që nuk mund t’i mashtrojë asnjë aventurier.”. Nuk mund ta mashtrojmë sot ne Bashkimin Europian se kryem zgjedhjet të lira dhe të ndershme, nuk mund ta

mashtrojmë se kemi një demokraci funksionale dhe një shtet në shërbim të qytetarëve. Këtu u drejtohem në veçanti qytetarëve me një thënie të Ruzveldit: “Demokracia nuk mund të ketë sukses nëse ata, që janë të destinuar të bëjnë zgjedhjen e tyre, nuk zgjedhin në mënyrë të mençur.” dhe këtu nuk u takoi atyre politikanëve, të cilët nxjerrin të pafajshëm qytetarët. Në zgjedhjet e 25 prillit votat kundër qeverisë duhej të ishin në ato përmasa që ata do të manipulonin dhe sërish të tepronin. Të nderuar qytetarë, demokracia nuk është një recetë, është arritje dhe çdo popull gëzon atë nivel demokracie që ka arritur me përpjekjet e tij.

Ngrihuni, zgjuhuni! Demokracia nuk është as në dorën e Kryeministrit, as në dorën e qeverisë, as në dorën e qeverisë, as të opozitës dhe as të deputetëve, por është në dorën tuaj dhe aq sa ju do të luftoni për të, në atë nivel do ta gëzoni. Të nderuar kolegë, nuk dëgjova asnjë fjalë në programin e qeverisë për të drejtat e minoriteteve. U bë një ligj në vitin 2017. U zotuan në Këshillin e Europës, në Bashkimin Europian që deri në maj të vitit 2018 do të ishte plotësuar kuadri ligjor edhe me 12 vendime të Këshillit të Ministrave. Ende sot në vitin 2021 vetëm 8 nga këto vendime të Këshillit të Ministrave janë miratuar Sërish në raportin e tij të fundit Këshilli i Europës i bie fort kambanës se duhet të bëhet realitet respektimi i konventës kuadër, që ende nuk është respektuar në vendin tonë. Politika e qeverisë në lidhje me minoritetet, fatkeqësisht, nuk është politikë integruese, është politikë asimiluese në kundërvënje të frymës bashkëkohore europiane. Në lidhje të ngushtë me këtë do t’i referohesha edhe një aspekti të çështjes së pronave.

Zotërinj të nderuar, në të shkuarën kam qenë nga ata deputetë që, në mënyrë sistematike, kam denoncuar strategjinë 7-vjeçare të qeverisë së sotme për tjetërsimin e statusit të pronës, në mënyrë të veçantë në bregun e Jonit. Për fat të keq, një politikë e tillë po vazhdon në përmasa edhe më të mëdha dhe me ritme gjithmonë në intensifikim. Duhet të bëhemi barrierë. E drejta e pronës është e drejtë e shenjtë. Në këtë kuadër kemi një detyrim të madh moral. Kemi qenë vendi i parë ose ndër të paktët në botë që i kemi shpallur luftë Perëndisë. Sot e kësaj ditë komuniteteve fetare nuk u është kthyer prona, me përjashtim të disa rasteve për show politik, që u janë dhënë titujt e pronësisë.